REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 926/20
Datë/Datum. 30.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Kastrati	18.11.2020	30.11.2020	926/20
Emri dhe Mbiemri i ekspertit shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.11.2020, OE "NAS SYSTEMS SH.P.K." - Gjilan, ka parashtruar ankesë me nr: 926/20, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), ku është rekomanduar për kontratë D.P.T "Pro-Computers"- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit" me nr. të prokurimit: 651-19-7027-121, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Gjilan.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Te gjitha pretendimet per shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se nga ky AK jane te njentat sikurse ne vendimin e OSHP-se nr 112/20 te dates 11.03.2020,AK ka marre vendim per dhenje te kontrates te OE-se njejt sikur ne heren e pare ,duke mos marre per baze vendimin e OSHP-se I cili ka konstatuar se ka shkelje te dispozitave ligjore dhe lenda te kthehet ne rivleresim. Pra AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-se nr 112/20 te dates 11.03.2020 dhe ka shpallur perseri fitues te njejtin OE I cili nuk eshte I pergjegjeshum konform kerkesave te pershtatmerise teknlke dhe aftesise profesionalem te kerkuara ne dosje te tenderit. Ne kerkesen tone per rishqyrtim te vendimit te AK se te dates 28.10.2020 kemi kerkuar qe te merret per baze vendimi oshp-se dhe pretendimet e faktuara nga ana jone e te cilat jane konsideruar si te pa bazuara dhe AK ka vazdhuar tutje me procedure

Andaj kerkojme nga organi Juaj shqyrtues qe të marrë për bazë vendimi e OSHP-se nr 112/20 te dates 11.03.2020 si dhe pretendimet tona ne te cilat jane parashtruar ne ate vendim dhe ta urdheroj AK qe te anuloj vendimin per dhenje te kontrates dhe ta udhezoj AK te merr vendim sipas konfor dispozitave ligjore te LPP-se

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të datës 23.10.2020, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Gjate hapjes se ofertave kanë aplikuar 3(tre) OE ne formë elektronike , komisioni i vlerësimit gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit te ofertave ka konstatuar se te tre (3) kanë qenë te përgjegjshëm ndërsa nje (1) ka qene i suksesshëm.

Meqenëse kriteri për dhënie te kontratës është tenderi me i përgjegjshëm dhe çmimi me i lirë, komisioni i vlerësimit rekomandon zyrtarin përgjegjës te prokurimit qe me kontratë ta shpërblejë OE DPT "Pro-Computers" ishte oferta e përgjegjshme me çmimin me të ulet në vlerë prej 54,796.00€.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues i OSHP ka nxjerrë vendimet si në vijim:

- Me datë 08.10.2019, ka nxjerrë vendimin numër 688/19;
- Me datë 26.12.2019, ka nxjerrë vendimin me numër 828/19;
- Me datë 11.03.2020, ka nxjerrë vendimin me numër 112/20;
- Me datë 26.06.2020, ka nxjerrë vendimin me numër 290/20;

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "NAS SYSTEMS SH.P.K."- GJILAN

Sqarim hyrës: Ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet, për pretendimet e njëjta ka nxjerrë vendimin me numër 112/20.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë nxjerrë edhe vendime tjera të sipërpërmendura, mirëpo, pretendimet e OE-së janë të njëjta me ato që janë shqyrtuar në vendimin numër 112/20 të datës 11.03.2020. Për më tepër, në sistemin e E-Prokurimit dhe nga AK, nuk janë paraqitur dokumente tjera të cilat mund të jenë kërkuar nga OE-të në bazë të dispozitave ligjore, gjatë fazës së rivlerësimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që bazuar në vendimin e OSHP-së nr. 112/20 të datës 11.03.2020, në bazë të rregullores së punës së OSHP-së (neni 16.3) kjo lëndë të konsiderohet si çështje e gjykuar më parë "res judicata" dhe rrjedhimisht në bazë të këtij vendimi të OSHP-së, ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim, konform dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal - Gjilan
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – "NAS SYSTEMS SH.P.K." - GJILAN